VENDIM
Nr. 144, datë 26.12.2014

PËR RISHIKIMIN E ÇMIMIT UNIK TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË LICENCUARIT PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET E RINJ ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 15 MW PËR VITET 2013 DHE 2014

Në mbështetje të neneve 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar,vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 19.1.2007,"Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve",të ndryshuar, neneve 15, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr. 24, datë 11.4.2007, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s "Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 10 MW", Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë(ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.12.2014, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW, për vitet 2013 dhe 2014,

VENDOSI:

1. Çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitet 2013 e 2014, do të jetë respektivisht 9.73 lekë/kWh dhe 7.95 lekë/kWh.
2. KESH sh.a. dhe çdo i licencuar për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW, të akomodojnë efektet financiare të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e të licencuarve dhe KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti